10.B.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

**DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

**PROJEKTVENDIM**

Nr 1476, Datë 30. 01. 2026

**"PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2027 – 2029"**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja "b", pika 1.3 shkronja "c", nenit 41, pika 1, neni 54, shkronja "dh", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, nenit 34, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar ,VKB nr .114 date 15.12.2025 " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027 " Kryetari i Bashkisë i paraqet projekt vendimin përkatës, Këshillit të Bashkisë;

**Për të vendosur :**

1. Miratimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Lezhë, për periudhën 2027-2029, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**Pjerin Ndreu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

**DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

Nr. 1476/1 prot. Lezhë, me 30/01/2026

**RELACION**

**MBI PROJEKT VENDIMIN E PARAQITUR**

**"PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2027 – 2029"**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar .Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligjin nr.9920, datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKB nr.104, datë 26.11.2025 "Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve" , VKB nr .114 date 15.12.2025 " Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027 " paraqesim projekt vendimin per miratimin e raportit per vleresimin e te ardhurave per programin buxhetor afatmesem 2027-2029 .

Ky projekt vendim paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat nga taksat vendore, taksat e ndara,tarifat vendore dhe te ardhura te tjera . Informacioni jepet mbi:

- të ardhurat faktike të dy viteve të fundit 2024-2026
- buxhetin fillestar për vitin aktual 2026
- parashikimet për tre vitet e ardhshme 2027-2029

**Vlerësimi dhe parashikimi afatmesëm i të ardhurave :**

është faza e parë për hartimin e Programit Buxhetor afatmesëm 2027-2029.

**_Planifikimi i të ardhurave :_**

Llojët e taksave dhe tarifave sipas buxhetimit:

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" *i ndryshuar* dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në të ardhurat vendore, që vijnë si rezultat i aplilkimit të taksave vendore, që vilen nga Njësitë Vendore, përfshihen:

1. Tatimi i Thjeshtuar i Fitimit (Për biznesin e Vogël)
2. Taksa mbi pasurinë;
3. Taksa e tabelës;
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
5. Taksa e Fjetjes në Hotele
6. Taksa të përkohshme

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Lezhë e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Parashikimi i të ardhurave është mbështetur në ecurinë e realizimit të tyre në vitet e mëparshme si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke i mbështetur në aktet ligjore për to. Parashikimi i këtyre zërave është bërë duke pasur parasysh kapacitetet mbledhëse, bazën tatimore dhe rritjen e numrit të subjekteve taksapaguese nga vitit ne vit.

Paketa fiskale e Bashkisë Lezhë reflekton një politikë thellësisht të qartë për uljen e nivelit të taksave dhe tarifave në kufirin minimal të kornizës ligjore për taksat dhe tarifat. Më poshte disa prej këtyre politikave:

1. Taksa e ndërteses për qëllime banimi 30% (pragu maksimal i lejurar) më i ulet nga referenca ligjore
2. Taksa e ndërteses për biznesin 30% (pragu maksimal i lejurar) më i ulet nga referenca ligjore
3. Taksë Toke Bujqësore zero kur ato mbillen me kultura dru frutorë dhe vreshtari për pesë vitet e para nga casti i mbjelljes.
4. Tarifa vendore zero per ;
   - Familjet,që kanë krye-familjarin invalid;
   - Familjet, që kanë në përbërjen e tyre, të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë,

- Familjet, që janë përfituese të ndihmës ekonomike;
- Pensionistët e vetëm ose me persona madhor të papunë ose persona Invalid.
- Gratë e dhunuara
- Gratë kryefamiljare me fëmijë deri në moshën 18 vjeç dhe ose deri në përfundimin e studimeve të larta (
- Familje të varfëra, me nivel ekonomik të ulët, por që arrijnë të plotësojnë kriteret për t'u trajtuar me ndihmë eknomike
- Nënat Beqare

5. Tarifa vendore zero per Kompanitë e trasportit publik kur sherbejnë kategorinë e
6. Tarife pastrimi zero per shoqatat e themeluara nga pensionistë ose persona me aftësi të kufizuara
7. Reduktim nga tarifa e pastrimit, në masën 50%, bizneset e krijuara nga gra kryefamiljare që kanë tre ose më shumë fëmijë

Bashkia Lezhë tashmë ka implementuar sistemin e ri të taksave elektronik ku është ndërtuar baza e te dhënave të taksapaguesve biznes dhe familjare. Ky sistem gjithashtu zbaton me përpikmeri paketën fiskale të miratuar duke kalkuluar në mënyre atutomatike detyrimet vjetore për cdo takse dhe tarifë dhe u jep mundësi taksapaguesve të regjitstrohen në të për të ndërvepruar në kohë reale mbi kerkesë ankesat e tyre, verifikimin e detyrimeve të tyre si dhe kronologjinë e detyrimeve ndër vite dhe pagesat e taksave zë për zë .

Parashikimi i të ardhurave është mbështetur në ecurinë e realizimit të tyre në vitet e mëparshme si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke i mbështetur në aktet ligjore për to.
Parashikimi i këtyre zërave është bërë duke pasur parasysh kapacitetet mbledhëse, bazën tatimore dhe rritjen e numrit të subjekteve taksapaguese.
Drejtoritë dhe Institucionet që realizojnë të ardhurat kryesore janë të renditura si më poshtë:

- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime e reja dhe tarifën e shqyrtimit të lejes për punime;
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore me taksën e pasurise , taksën e reklamës dhe tarifën e zënies së hapësirës publike;
- Drejtoria.e sherbimeve publike me tarifat vendore
- Agjenti tatimor Ujësjellës Kanalizime Lezhë;
- Drejtoria e Arsimit dhe Rinise, Drejtoria e sherbimit social per te ardhura te tjera

Të ardhurat për vitet 2027-2029 parashikohen të jenë në nivelet si më poshtë:

*Tabela 1*

**Në 000/leke**

| Nr. | Emertimi | Fakt 2024 | Fakt 2025 | Plan 2026 | Plan 2027 | Plan 2028 | Plan 2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Te ardhura tatimore | 733 396 | 621 221 | 1 046 000 | 1 109 500 | 1 155 000 | 1 166 550 |
| 2. | Te ardhura jo tatimore | 290 937 | 474 962 | 489 369 | 496 972 | 511 921 | 516 963 |
| | Totali | **1 024 333** | **1 096 183** | **1 535 369** | **1 606 472** | **1 666 921** | **1 683 513** |




**Peshen kryesore ne parashikin e te ardhurave e zene te ardhurat tatimore me 68 % vitin e pare dhe 69 % dy vitet ne vazhdim.**

Kategoritë e taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave për vitet 2027-2029 janë kryesisht si në tabelën nr.2.

*Tabela 2*

| Nr. | Emertimi | Plan 2027 | Plan 2028 | Plan 2029 |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 11% | 11% | 11% |
| 2. | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 47% | 47% | **47%** |
| 3. | Tarifa e pastrimit | 8% | 8% | **8%** |
| 4. | Tarifa e zënies së hapsirës publike | 5% | 5% | **5%** |

Të ardhurat që mblidhen nga administrata e Bashkisë Lezhë në vitet 2027-2029 parashikohet që të kenë një trend rritje me:

- 4.63% nga viti 2026 në vitin 2027
- 3.76% nga viti 2027 deri në vitin 2028
- Dhe 1% nga viti 2028 ne vitin 2029

Sa me siper kërkojmë miratimin e këtij projekt-vendimi për vazhdimin e procesit të hartimit të PBA-së 2027–2029, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe afatet e përcaktuara për përgatitjen e dokumenteve buxhetore afatmesme.

Miratimi i këtij projekt-vendimi do të mundësojë vijimin e procedurave përkatëse, koordinimin ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe përgatitjen në kohë të dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029.

**KRYETAR**

**PJERIN NDREU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

PASQYRA NR.1

| PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË LEZHË 2027-2029 | | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Fakt | Fakt | Plani | Plani | Plani | Plani |
| A | Të Ardhura nga Burimet e Veta | 1,024,333.20 | 1,096,182.58 | 1,535,369.00 | 1,606,472.00 | 1,666,921.00 | 1,683,506.51 |
| A.1 | Të Ardhura nga Taksat Vendore | 649,556.00 | 525,787.95 | 955,500.00 | 1,012,000.00 | 1,049,500.00 | 1,059,995.00 |
| A.1.1 | Taksa vendore mbi biznesin e vogël | 1,386.10 | 472.37 | 500.00 | 500.00 | 500.00 | 505.00 |
| A.1.2 | Taksa mbi pasurinë e paluajtshme | 138,958.90 | 153,773.50 | 180,000.00 | 184,500.00 | 189,000.00 | 190,890.00 |
| A.1.2.1 | Taksa mbi ndërtesën | 91,415.50 | 96,998.96 | 110,000.00 | 112,000.00 | 114,000.00 | 115,140.00 |
| A.1.2.2 | Taksa mbi tokën bujqësore | 9,737.50 | 10,260.27 | 10,000.00 | 11,000.00 | 12,000.00 | 12,120.00 |
| A.1.2.3 | Taksa mbi truallin | 21,984.90 | 23,534.65 | 30,000.00 | 30,500.00 | 31,000.00 | 31,310.00 |
| A.1.2.4 | Taksa mbi transaksionet e pasurisë | 15,821.00 | 22,979.61 | 30,000.00 | 31,000.00 | 32,000.00 | 32,320.00 |
| A.1.3 | Taksa vendore në shërbimin hotelier | 43,630.20 | 45,889.64 | 55,000.00 | 57,000.00 | 60,000.00 | 60,600.00 |
| A.1.4 | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 460,412.10 | 318,047.35 | 700,000.00 | 750,000.00 | 780,000.00 | 787,800.00 |
| A.1.5 | Taksa e tabelës | 2,472.30 | 4,602.43 | 15,000.00 | 15,000.00 | 15,000.00 | 15,150.00 |
| A.1.6 | Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llot. Vend. | - | - | - | - | - | - |
| A.1.7 | Taksa e përkohëshme | 2,696.40 | | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,050.00 |
| A.1.8 | Taksa e përkohëshme 1 | - | 453.02 | - | - | - | - |
| A.1.9 | Taksa e përkohëshme 2 | | 2,549.66 | - | - | - | - |
| A.2 | Të Ardhurat nga Taksat e Ndara | 83,840.50 | 95,433.03 | 90,500.00 | 97,500.00 | 105,500.00 | 106,555.00 |
| A.2.1 | Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme | | | | | | |
| A.2.2 | Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura | 52,117.00 | 56,864.41 | 55,000.00 | 57,000.00 | 60,000.00 | 60,600.00 |
| A.2.3 | Taksa e rentës minerare | 481.80 | 321.39 | 500.00 | 500.00 | 500.00 | 505.00 |
| A.2.4 | Taksa mbi të ardhurat personale | 31,241.70 | 38,247.24 | 35,000.00 | 40,000.00 | 45,000.00 | 45,450.00 |
| A.2.5 | Taksa të tjera | - | - | - | - | - | - |
| A.3 | Të Ardhurat nga Tarifat Vendore | 275,044.70 | 247,054.24 | 315,000.00 | 322,603.00 | 337,552.00 | 340,843.82 |
| A.3.1 | Tarifa me menaxhimit te mbetjeve | 121,337.20 | 119,227.09 | 135,590.00 | 136,243.00 | 138,542.00 | 139,927.42 |
| A.3.1.1 | Tarifa e pastrimit për familjet | | 47,690.84 | 61,187.00 | 61,481.00 | 62,518.00 | 63,143.18 |
| A.3.1.2 | Tarifa e pastrimit për institucionet | | 2,384.54 | 2,102.00 | 2,112.00 | 2,148.00 | 2,169.48 |
| A.3.1.3 | Tarifa e pastrimit për biznesin | | 69,151.71 | 72,301.00 | 72,650.00 | 73,876.00 | 74,614.76 |
| A.3.2 | Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve | | - | - | - | - | - |
| A.3.3 | Tarifa për ndriçimin publik | 22,976.10 | 23,061.46 | 38,000.00 | 38,000.00 | 38,000.00 | 38,380.40 |
| A.3.3.1 | Tarifa për ndriçimin publik nga familjet | | 9,224.58 | 14,440.00 | 14,440.00 | 14,440.00 | 14,584.40 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.3.3.2 | Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet | | | | | | |
| A.3.3.3 | Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi | | 461.23 | 665.00 | 665.00 | 665.00 | 672.00 |
| A.3.4 | **Tarifa për gjelbërimin** | | 13,375.65 | 22,895.00 | 22,895.00 | 22,895.00 | 23,124.00 |
| A.3.4.1 | Tarifa për gjelbërimin nga familjet | **17,702.90** | **17,769.05** | **23,000.00** | **23,000.00** | **23,000.00** | **23,230.00** |
| A.3.4.2 | Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet | | 7,115.62 | 680.00 | 680.00 | 680.00 | 686.80 |
| A.3.4.3 | Tarifa për gjelbërimin nga bizneset | | 335.38 | 630.00 | 630.00 | 630.00 | 636.30 |
| A.3.5 | **Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë** | | 10,318.05 | 21,690.00 | 21,690.00 | 21,690.00 | 21,906.90 |
| A.3.5.1 | Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë | **97,701.10** | **72,517.44** | **98,910.00** | **105,760.00** | **118,310.00** | **119,409.00** |
| A.3.5.2 | Tarifa për dhënien e liçensave, lejeve e autorizimeve | | - | 30.00 | 30.00 | 30.00 | 30.00 |
| A.3.5.3 | Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 3,962.00 | 1,317.20 | 1,000.00 | 1,000.00 | 1,000.00 | 1,010.00 |
| A.3.5.4 | Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura | 13,955.40 | 10,072.36 | 15,000.00 | 15,700.00 | 16,500.00 | 16,665.00 |
| A.3.5.5 | Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit | | - | - | - | - | - |
| A.3.5.6 | Tarifa e parkimit për mjetet e liçensuara dhe vendparkime publike | 1,459.30 | 971.07 | 1,400.00 | 1,500.00 | 1,600.00 | 1,616.00 |
| A.3.5.7 | Tarifa për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj | 8,143.50 | 7,639.96 | - | - | - | - |
| A.3.5.8 | Tarifa për pyjet dhe kullotat | | - | - | - | - | - |
| A.3.5.9 | Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja | 5.20 | 7,279.43 | 500.00 | 550.00 | 700.00 | 700.00 |
| A.3.5.10 | Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave | 1,131.00 | 907.00 | 1,300.00 | 1,300.00 | 1,300.00 | 1,313.00 |
| A.3.5.11 | Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille | 65,496.70 | 40,932.48 | 72,000.00 | 78,000.00 | 89,500.00 | 90,395.00 |
| A.3.5.12 | Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet) | | - | - | - | - | - |
| A.3.5.13 | Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj | | - | - | - | - | - |
| A.3.5.14 | Tarifa të tjera (Me vendim Këshilli)(Dekor, Varrezat) | | - | - | - | - | - |
| A.3.6 | **Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj** | 3,548.00 | 3,397.94 | 7,680.00 | 7,680.00 | 7,680.00 | 7,680.00 |
| A.3.6.1 | Bibloteka | **15,327.40** | **14,479.21** | **19,500.00** | **19,600.00** | **19,700.00** | **19,897.00** |
| A.3.6.2 | Muzeumet | | | - | - | - | - |
| A.3.6.3 | Teatri | | | 2,500.00 | 2,600.00 | 2,700.00 | 2,727.00 |
| A.3.6.4 | Qendra kulturore e fëmijëve | | | - | - | - | - |
| A.3.6.5 | Pallati i sportit | | | - | - | - | - |
| A.3.6.6 | Kultura | | - | - | - | - | - |
| | | 1,693.30 | 1,828.50 | - | - | - | - |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.3.6.7 | Mensa (Konviktet) | 185.80 | 166.06 | - | - | - | - |
| A.3.6.8 | Kopshtet | 9,799.50 | 9,254.49 | 12,000.00 | 12,000.00 | 12,000.00 | 12,120.00 |
| A.3.6.9 | Çerdhet | 3,648.80 | 3,230.16 | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,050.00 |
| A.3.7 | Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime | | | - | - | - | - |
| A.3.8 | Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit | | | - | - | - | - |
| A.3.9 | Tarifa e përkohëshme | | | - | - | - | - |
| A.4 | Të Ardhurat e Tjera | **15,892.00** | **227,907.36** | **174,369.00** | **174,369.00** | **174,369.00** | **176,112.69** |
| A.4.1 | Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë | 5,304.30 | 12,518.46 | 5,687.00 | 5,687.00 | 5,687.00 | 5,743.87 |
| A.4.2 | Kthimi nga investimet kapitale | | | - | - | - | - |
| A.4.3 | Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë | | | - | - | - | - |
| A.4.4 | Kthimi nga partneriteti publik privat | | | - | - | - | - |
| A.4.5 | Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet | | | - | - | - | - |
| A.4.6 | Shitja e mallrave dhe shërbimeve | | | - | - | - | - |
| A.4.7 | Kundravajtjet administrative (Gjobat) | 8,997.50 | 8,588.46 | 10,500.00 | 10,500.00 | 10,500.00 | 10,605.00 |
| A.4.8 | Sekuestrime dhe Zhdëmtime | | | - | - | - | - |
| A.4.9 | Kuotat e anëtarësisë së bashkive | | | - | - | - | - |
| A.4.10 | Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore | | | - | - | - | - |
| A.4.11 | Grante nga ndihma ndërkombëtare | | | - | - | - | - |
| A.4.12 | Shitja e aseteve financiare | | | - | - | - | - |
| A.4.13 | Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme | | | - | - | - | - |
| A.4.14 | Të tjera | 1,590.20 | 206,800.45 | 158,182.00 | 158,182.00 | 158,182.00 | 159,763.82 |
| | **Shuma Totale** | **1,024,333.20** | **1,096,182.58** | **1,535,369.00** | **1,606,472.00** | **1,666,921.00** | **1,683,506.51** |